# DËSHMI ARKIVI

**A-453604**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Qeveria në Greqi premton ulje të çmimit të naftës, Mitsotakis: Mbështetje nga shteti dhe rafineritë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/17/qeveria-ne-greqi-premton-ulje-te-naftes-se-ngrohjes-dhe-rritje-te-ndihmes-mitsotakis-kerkoj-stabilitet-pas-zgjedhjeve/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 21:11:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 20:45:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 20:44:00 UTC → 17 shtator 2026, 20:46:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bdb962226d84e1f10b4a35406f635a573bedac4675903ffcced82a9b236e820a` |
| TEKSTI | `93e38eca585462dfd37e13e6488e694d0d0d431a3f2b9294ec78d23a0d695bae` |
| PAMJA | `4e4f19d4a8fe2df769b6da91e74ece647dc763941a46b4b05adc57dc80534d1f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5e72b2b26998c7ea930539dfcde2e09be9d703a7851cda97275fb0984cc37437` |
| E MËPARSHMJA | `81556b64023210110ddf121789bc1fde73d18003671ed2a1d11b6794d6b68911` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5e72b2b26998c7ea930539dfcde2e09be9d703a7851cda97275fb0984cc37437`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | TË FUNDIT

# Qeveria në Greqi premton ulje të çmimit të naftës, Mitsotakis: Mbështetje nga shteti dhe rafineritë

17/09/2026 22:45



**Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis në një intervistë në kanalin televiziv ERT paralajmëroi ndërhyrje për çmimin e naftës së ngrohjes, e cila do të dalë në treg më 15 tetor.**

Objektivi i qeverisë është që çmimi fillestar të jetë nën 1,75 euro për litër, nga 2 euro që është tani , ndërsa pritet edhe rritje horizontale e ndihmës për ngrohjen.

Masat e hollësishme do të shpallen në fillim të javës së ardhshme. Mitsotakis la të hapur mundësinë e kufizimit të marzhit të fitimit në treg dhe, nëse do të jetë e nevojshme, të një uljeje të përkohshme të akcizës.

Ai tha se do të ketë mbështetje nga shteti dhe rafineritë, ndërsa ndërhyrja mund të shtrihet edhe te nafta për automjetet gjatë tetorit.

Çmimet e karburanteve në Greqi mbeten të larta. Sipas të dhënave më të fundit zyrtare, për 16 shtatorin, benzina pa plumb kushtonte mesatarisht 2,173 euro për litër, ndërsa nafta për automjetet 2,150 euro për litër. Nafta e ngrohjes të cilën përdorin mbi 2 milion familje , ose 47% e popullsisë, nuk shitet ende në treg, pasi sezoni nis në mes të tetorit, por deri tani përllogaritet se do jetë me 2 euro litri.

Në planin ekonomik, kryeministri tha se masat e shpallura në Panairin e Selanikut janë të llogaritura në buxhet dhe se Greqia nuk rrezikon një krizë të re borxhi, pavarësisht pasigurisë ndërkombëtare.

Për situatën politike, Mitsotakis kërkoi stabilitet pas zgjedhjeve dhe përsëriti se synimi i tij është një qeveri e vetme e Demokracisë së Re.Sa i përket marrëdhënieve të acaruara me Turqinë, ai tha se retorika nga Ankaraja është ashpërsuar, por Athina nuk do të hyjë në një përplasje deklaratash. Nuk është caktuar takim me presidentin Erdogan në Nju Jork, ka deklaruar ai , megjithatë ka shtuar se një takim dypalësh nuk përjashtohet.

**Top Channel**

## Bota »



Kthesa politike në Suedi, kryeministri Kristersson jep dorëheqjen pas rezultatit të zgjedhjeve



Trump kërcënon BE-në pas afrimit me Kanadanë: Do të vendos tarifa shumë të rënda

17/09 17:55



I akuzuan për tradhti bashkëshortore, dy të dashuruarit në Indonezi rrihen me 100 goditje me kamxhik.

## Kryesore



Dënimi me 81 vite i ish-liderëve të UÇK-së, Grenell në Top Story: Kosova s'ka nevojë që vendimet t'i marrë një gjykatë në Holandë, duhet të vendosë vetë

21:52

Ekskluzive/ Poezi imagjinare me nënën, si Jakup Krasniqi i jepte vetes zemër në paraburgim

11:39

Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

14:16

SHBA rrit normat e interesit/ Rezerva Federale sfidon presionin e Trump: Inflacioni mbetet shumë i lartë

12:58

Kombëtarja shqiptare nis rrugëtimin e Nations League, të shtunën Maran publikon listën e të përzgjedhurve

12:35

## Më të lexuarat

E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Richard Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me bluzën kuqezi

Kryeministri Rama viziton Malin Athos në Greqi, qëndron gjatë natës në Manastirin e Vatopedisë

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

Daja i deputetes së PS e rrahu dhe i plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjine Çaushit: Ja si qëndron e vërteta

Deputetët në seancë plenare. Përshkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

"Gjyshi i saj një vrasës serial, i ka marrë jetën shumë njerëzve të pafajshëm"/ Akuzat e reja të SPAK për Ballukun, Berisha: Po tregon që është mbesa e Beqir Ballukut

17/09 18:52

Gruaja rrëzohet nga dhimbja

17/09 17:12

Transportonte flori dhe para me “Porsche Cayenne”, arrestohet 30-vjeçari në Roskovec. Sekuestrohet “Bently” me vlerë 250 mijë euro

Dënimi me 81 vite i ish-liderëve të UÇK-së, Grenell në Top Story: Kosova s’ka nevojë që vendimet t’i marrë një gjykatë në Holandë, duhet të vendosë vetë



Policia gjeti trupin e pajetë të 3-vjeçarit në liqen, babai i të voglit: Ishte një djalë i ëmbël dhe i pafajshëm

17/09 16:57



Erdogan për anëtarësimin e Turqisë në BE: Nuk është më prioriteti ynë, ata do të humbasin, jo ne

17/09 16:03



Partneritet i ri strategjik, kryeministri kanadez Mark Carney: Mirëpresim ambicien e BE-së për një aleancë më të ngushtë

17/09 14:35

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Atmosfera e planetit thyen rekord, niveli i avujve të ujit rrit rrezikun



Top Channel/ Grenell: Kosovës nuk i duhet gjykata e Hagës, veprojnë politikisht



Top Channel/ Nato-Rusi, tension në ajër, Aleanca ngre avionët luftarakë



Top Channel/ Protesta e 110, organizatorët akuza policisë



Top Channel/ Çfarë ndodhi në protestën e 110, fjalime, mesazhe për dorëheqje dhe marshim në Tiranë



Top News- Kundërofensiva ukrainase “shpartallon” forcat ruse, humbje të mëdha për Kremlinin



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.